

NewsLetter 20 Years



THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

OPINION EKONOMIK

COVID-19, KATASTROFAT NATYRORE DHE EFEKTET NË EKONOMI

Avni Ponari
CEO SIGAL UNIQA Group Austria

Koronavirusi është një fatkeqësi e madhe botërore, e paparashikuar dhe e paprogramuar gjëkund, por në fund të fundit ne duhet të dalim edhe me disa konkluzione nga kjo betejë e hidhur, dhe me siguri këtë po bëjnë të gjitha shtetet...

» Në faqen 3

Lajme Anëtarësh

Welcome Anëtar i ri
Albanian Consultancy

Lajme Anëtarësh
“Cape of Rodon Green Village”

» Në faqen 2

COVID 19- ECONOMIC

NEWS

Pasojet Covid-19 në tregun bankar shqiptar - Raporti BEI: Kredia do të ndikohet negativisht, por tregu ka një pozitë të kënaqshme

» Në faqen 6

KLIMA E BIZNESIT

ANKETA E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE,

Sektorët që u goditën më shumë nga COVID-19

Në faqen 2



EKONOMI

NDIKIMI I SEKTORIT TË NDËRTIMIT NË EKONOMINË SHQIPTARE

Klodiana Ajazi
INOVEST

Në faqen 5

Sektori i ndërtimit është një nga veprimtaritë më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare, që ndikon drejt për drejt në zhvillimin ekonomik të vendit. Ky sektor ka një ndikim direkt në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), ku në vitin 2019 aktivitete të pasurive

të paluajtshme kanë pasur një ndikim në rritjen e PBB-së me +0,51 pikë përqindje dhe vetë ndërtimi me +0,43 pikë përqindje. Ndikimi i këtij sektori vihet re në shumë aspekte siç janë punësimi, taksat e paguara në pushtetin vendor, likuiditeti qarkullues, zhvillimi në infrastrukturë, zhvillimi i zonave, etj.



ANKETA E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE,

SEKTORËT QË U GODITËN ME SHUME NGA COVID-19



Pandemia e COVID-19 paralizoi për 2 muaj gjysmën e aktivitetit ekonomik të vendit. Një studim i Këshillit të Investimeve konstaton se 47% e ndërmarrjeve në Shqipëri ndaluan plotësisht

aktivitetin gjatë masave bllokuese në muajt mars, prill dhe pjesërisht në maj. Një studim i bërë nga Këshilli i Investimeve tregon se nga të gjithë sektorët e ekonomisë, më i prekuri rezultoi të jetë turizmi, i e bizneseve në këtë industri patën një mbyllje totale, ndërsa e vetmja degë që vazhdoi punën është bujqësia. Bizneset kërkojnë nga qeveria që të ndërmarë një

sërë masash për rigjenerimin e ekonomisë pas pasojave të shkaktuara nga COVID-19. Kërkesat janë adresuar në anketën e zhvilluar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve dhe janë të ndara sipas nevojave të sektorëve. Konkretisht, sektori i turizmit, i cili rezultoi dhe më i prekuri, sugjeron që bizneset të mos paguajnë tatim-fitim për vitin 2019, në mënyrë që të kenë

disa rezerva për të mbajtur kompanitë në këmbë për 2020-2021, si edhe të reduktohet norma e tatimfitimit me 5-10% për vitin 2020-2021.

Ndërkaq, anketa bën me dije se të paktën 86% e kompanive shqiptare nuk kanë asnjë plan emergjence të miratuar prej tyre, mbi bazën e të cilit mund të merren masa që zvogëlojnë ndikimin e një fatkeqësie. Anketa e Këshillit

të Investimeve me biznesin, për efektin e koronavirusit, tregon se më i shkuajdesur nga të gjithë sektorët, duke mos menduar një plan emergjence, është sektori i ndërtimit.

"Kompanitë në Shqipëri nuk kanë plan emergjence (86% e kompanive nuk kanë plan të aprovuar emergjence). Sjellja është e njëjtë, pavarësisht nga madhësia apo sektori ekonomik. Kompanitë që operojnë në Shërbime dhe Industri janë më të përgatitura për t'u përballur me raste emergjence, megjithëse në nivele shumë të ulëta (17% e kompanive të shërbimeve dhe 16% e ndërmarrjeve industriale deklarojnë se kanë një plan emergjence të miratuar). Kompanitë e ndërtimit dhe tregtisë janë më pak të përgatitur" thuhet në dokument.



Anëtar i ri



ALBANIAN CONSULTANCY
YOUR ACCOUNTING PARTNER

Albanian Consultancy është një kompani që ofron shërbime në fushën e gjerë të kontabilitetit, auditimeve, konsulencës fiskale, taksimit, përfaqësime të ndryshme, vlerësime asetesh, vlerësime kompanish, vlerësime pasurish, kontroll të brendshëm, likuidime, bashkime, ndarje shoqërisht tregtare dhe të tjera të ngjashme. E pranishme prej më se 10 vitesh në Shqipëri me një ekip të kualifikuar e të përkushtuar në punë, me eksperiencën personale prej mbi 15 vitesh, me kualifikime akademike brenda dhe jashtë vendit, me certifikime të aftësive profesionale të ndryshme, Albanian Consultancy ndërthur eksperiencën dhe kualifikime juristësh për ligjet tregtare, vlerësues pasurish, kontabilitet të miratuar si dhe auditues ligjorë.

Marrëdhënia me partnerët tanë të biznesit është një marrëdhënie e sinqertë. Ne ofrojmë një paketë të integruar shërbimesh sipas nevojave të kompanive përkatëse, dhe synimet kryesore të kompanisë sonë

janë kërkesat e larta etike dhe profesionale të shërbimeve që ajo ofron. Klientëve u shërbejmë me përkushtim dhe përpikmëri pavarësisht madhësisë apo rëndësisë të aktivitetit. Shërbimi ynë i jepet një numri të madh klientësh, biznesesh të vogla si dhe kompani të strukturuar, duke i ndihmuar që me punën tonë të përmirësojnë projektet tatumore, menaxhimin e fluksit të parash dhe të tejkalojnë pengesat rregullatore që funksioni bazë i financës nuk mund t'i kryejë.

Nga viti 2018, shoqëria jonë është pjesë e "Russell Bedford International" – rrjeti ndërkombëtar i firmave të pavarura profesionale, i cili përmbledh shoqëri nga më të mirat e këtij sektori, duke harmonizuar përvojat e tyre me standartet më të larta profesionale ndërkombëtare. Suksesi i kompanisë sonë bazohet në punën dhe partnerët me të cilët ne bashkëpunojmë. Ne pranojmë kandidatët më të mirë pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar apo çdo formë tjetër diskriminimi.



"Cape of Rodon Green Village" një projekt ndryshe

Kepi i Rodonit, një vend me vlera të shumta natyrore, kulturore dhe historike, ndër vite ishte jo shumë i eksploruar. Pavarësisht kësaj, çdokush, pa më të voglin dyshim, adhuronte magjinë që të fal ky vend, natyrën e mbrojtur, detin e kristaltë, pamjen mahnitëse dhe format e terrenit kodrinor. Për shumë vite, vizitorë të këtij vendi të veçantë kanë qenë të apasionuarit pas natyrës, privatësisë dhe eksperiencës ndryshe. Sot, situata e Kepit të Rodonit ka një ndryshim rrënjësor. Sot, Kepi i Rodonit po kthehet në një destinacion me vlerë të lartë turistike. Një investim që i hap rrugën zhvillimit të këtij vendi ka filluar të marrë jetë nën emrin "Cape of Rodon Green Village", si një resort me një koncept ndryshe dhe eco-friendly.

"Cape of Rodon Green Village" ofron vetëm 48 vila me 6 tipologji të ndryshme, duke u bërë kështu një projekt ekskluziv dhe me komunitet të përzgjedhur, pikërisht për ata që preferojnë privatësinë, qetësinë, të bukurën, të qenit pranë natyrës dhe të qenit ndryshe.

Kombinimi natyrë - arkitekturë - cilësi - vendndodhje, e bëjnë këtë projekt jo vetëm vendin e preferuar për pushime, por edhe një nga vendet më të sigurta për investim në sektorin e pasurive të paluajtshme në tregun vendas. Pjesë e këtij resorti është edhe një hotel luksoz, i cili do të menaxhohet me një paketë ndërkombëtare, duke ofruar shërbimin e tij në 12 muaj të vitit, që përkthehet në rritje të fluksit të turistëve gjatë gjithë vitit, por edhe në përdorim më të gjatë të pronës në 12 muaj. Hoteli merr nën menaxhim vilat e banorëve në resort, duke i përfshirë në paketat e tij të shitjes, e kjo krijon një lehtësi që çdo banor të ketë një menaxhim profesional të pronës dhe garanci në qiradhënie, me qëllim kthimin e investimit sipas planeve.

Argumentet për këtë vend mund të vijnë në një listë më të gjatë, shtoj këtu faktin që Kepi i Rodonit, përveç natyrës mahnitëse dhe pozicionit strategjik, mbar vlera të shumta kulturore dhe historike, duke u bërë destinacion i preferuar i turistëve në çdo kohë, si i atyre vendas ashtu dhe të huaj.

Në një treg me kërkesë dhe ofertë të ndryshueshme, në kushtet e një jete dinamike, prona juaj në bregdet duhet të jetë e bukur, komode, cilësore, e aksesueshme lehtësisht, të vijë në formën e investimit, t'ju ofroj siguri... të gjitha sa më lartë përmendur kombinohen nën emrin "Cape of Rodon Green Village".



Armi Ponari

CEO SIGAL UNIQA Group Austria

Koronavirusi është një fatkeqësi e madhe botërore, e paparashikuar dhe e paprogramuar gjëkund, por në fund të fundit ne duhet të dalim edhe me disa konkluzione nga kjo betejë e hidhur, dhe me siguri këtë po bëjnë të gjitha shtetet.

Përtej gjithë kësaj, pjesa tjetër më e rëndësishme për të cilën duhet të flasim është ekonomia. Çfarë po ndodh me sistemet ekonomike dhe kush po goditet më shumë nga kjo pandemi? A i kemi nxjerrë mësimet nga kjo pandemi që po vazhdon të gjuhëzohet mbarë botën?

Siç thotë edhe historiani i njohur, Yuval Harari, "Ne nuk mund të parandalojmë shfaqjen e sëmundjeve të reja infektive, por sidoqoftë ne kemi fuqinë të frenojmë këtë lloj sëmundje epidemike dhe ta parandalojmë atë të vrasë miliona njerëz". Kësaj unë do t'i shtoja edhe që ne kemi mundësinë që të parandalojmë shkatërrimin e ekonomisë.

Kjo pandemi ekspozoi brishtësinë e ekonomive tona, duke paraqitur sfida madhore në zinxhirin e furnizimit dhe goditjen e bizneseve të tilla si bursa, linjat ajrore, udhëtimet, luhatjet e tregjeve financiare, sektorin ban-

kar dhe atë të sigurimeve dhe të të gjithë zinxhirit të shërbimeve në hoteleri-turizëm, bar-kafe dhe dyqane. Kështu, kjo pandemi nuk është thjesht një krizë mjekësore, por gjithashtu sociale dhe ekonomike.

Siç kuptohet, kjo pandemi nuk njih kufij, po rrezon të vegjël e të mëdhenj, të suksesshëm apo më

pak të suksesshëm, të bardhë apo me ngjyrë, e gjithë bota sot është e gjuhëzuar para saj. Në këtë situatë ku ndodhemi, pyetja që shtrohet është: kjo situatë e përbotshme apo edhe llojet e tjera të krizave dhe katastrofave që kemi kaluar apo që mund të vijnë në të ardhmen a kanë ndonjë mbrojtje?

Nevojat e mëdha kërkojnë zg-

COVID-19, KATASTROFAT NATYRORE DHE EFEKTET NË EKONOMI



jdhje të mëdha. Një vend i vogël është vështirë të mbrohet, por lehtë të qeveriset. Mjafton të kesh dëshirën dhe të vendosësh njerëzit në punë.

Në botë ka me qindra kompani që kanë të punësuar aq sa është e gjithë popullsia e punësuar në Shqipëri. Atëherë një skanim i mundshëm i të gjithë sektorëve mbi nevojat reale dhe më pas një vlerësim real, dhe jo vetëm kaq, por duke klasifikuar rreziqet e mundshme dhe mbrojtjet nga ana tjetër është i domosdoshëm.

Sigurimet në rrugë institucionale, skemat e garantimit dhe mbrojtjeve financiare për individin dhe kompanitë lindën si nevojë e kohës. Falë kësaj garancie siguruese askush nuk do të dëmtohet në mënyrë të pakthyeshme, sepse rreziku potencial është i mbuluar.

Nga pikëpamja social-ekonomike, pandemitë janë njësoj si katastrofat natyrore vetëm se katastrofat janë lokale ndërsa pandemitë globale.

Në 500 vite, sipas dokumenteve shkencore, përlogaritjet që bota të ketë kaluar 15 pandemi globale dhe mijëra katastrofa natyrore. Vetëm në Shqipëri, sipas raportit 2018, të FAO-s (Food and Agriculture Organization, të Kombeve të Bashkuara) në Shqipëri në 150 vitet e fundit kanë ndodhur 4000 katastrofa natyrore. Vetëm në 20 vitet e fundit, nga përmbytjet e mëdha është shpallur tri herë gjendja e "Katastrofës Natyrore". Përveç humbjes së jetëve njerëzore, ajo ç'ka këto pandemi kanë vlarë më tepër ka qenë ekonomia.

Sipas disa vlerësimeve të studiuesve Melecky dhe Raddatz 2011, katastrofat natyrore kanë rritur shpenzimet e qeverisë me një mesatare prej 15 për qind dhe kanë ulur të ardhurat me rreth 10 për qind gjatë pesë viteve pas një katastrofe, duke çuar në një rritje



të konsiderueshme të deficitit të përgjithshëm të buxhetit.

Tërmetet e vitit të kaluar vendosën në qendër të vëmendjes siguruesit, të cilët janë përmblytur nga kërkesat për kompensim dëmsh. Për të dy tërmetet janë dëmshpërblyer mbi 5000 qytetarë që kanë qenë të siguruar dhe të tjerë janë në proces. Tregu i sigurimeve ka paguar miliona euro, duke përmbytur detyrimet ndaj klientëve dhe duke treguar përgjegjshmëri për punën dhe misionin e tyre.

Po sa veta u dëmtuan nga tërmeti? Me mijëra. Sa përfituan? Shumë pak. Sepse duhet të ishim të gjithë të siguruar, për t'u mbrojtur financiarisht dhe që të ketë vijimësi normale të jetës. Të bën përshtypje që ato dy tre ditë pas tërmetit pati ndonjë të siguruar, si duket nga frika e momentit, më pas toka u qetësua dhe njerëzit heshtën! Përsëri në dorë të Zotit!

Situata është pothuajse e njëjtë tani. Nuk kemi tërmet, por kemi pandemi. A ka sigurim ndaj pandemisë? Patjetër që ka. Sot çdo ngjarje që ndodh në tokë është e sigurueshme. Nëse këto biznese që sot janë mbyllur përkohësisht do ishin të siguruar, atëherë gjithçka do ishte paguar. Pra, nëse një fason, hotel apo linjë ajrore do kishte marrë edhe këtë lloj sigurimi, përveç sigurimeve bazë, atëherë shoqëritë e sigurimit do bënin kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga pandemia.

Është shumë e domosdoshme që një kompani të sigurojë ndërprerjen e biznesit, sepse sigurimi krijon mundësinë që ta vijosh biznesin nësoj siç ka qenë më përpara. Sigurimi përfshin fitimin e munguar, pagat e punonjësve dhe këto janë të mirëpërcaktuara në kontratë, me një limit të përcaktuar në varësi të primit të paguar dhe rreziqeve të mbuluara, në bazë të kapaciteteve dhe fuqisë financiare të kompanisë e cila kërkon të sigurohet.

Por pyetja që natyrshëm lind është: Sa kompani në Shqipëri e kanë një sigurim të tillë? Në hi-



“Ndërsa nëse i referohemi botës së zhvilluar, atje jo vetëm biznesi që ka absolutisht të siguruar çdo gjë, por edhe individët nuk mund të mendohet që të mos kenë të paktën **3 sigurime: jetën, shëndetin dhe pronën.**”

storinë time 30-vjeçare me sigurimet, vetëm një kompani e huaj në Shqipëri pati siguruar çdo gjë, jetën e punonjësve, shëndetin e tyre, asetet e kompanisë dhe sigurimin e ndërprerjes së biznesit. Pra në 30 vite sigurime, vetëm një kompani e ka patur këtë sigurim dhe kjo natyrisht që ishte kompani e huaj.

Ndërsa nëse i referohemi botës së zhvilluar, atje jo vetëm biznesi që ka absolutisht të siguruar çdo gjë, por edhe individët nuk mund të mendohet që të mos kenë të paktën 3 sigurime: jetën, shëndetin dhe pronën.

Në Singapor për shembull, gjatë periudhës së pandemisë që po kalojmë, sistemi i serverave nuk arrinte të mbante ngarkesën e madhe të aplikimeve nga kërkesat për sigurim jete, shëndeti, etj.

Dua të sjell një shembull nga Austria sa i përket sigurimit të biznesit. Një prej fabrikave më të mëdha të prodhimit të birrës atje, e cila e kishte provuar para 102

vitesh një pandemi të tillë, atë të Gripit Spanjoll, i cili mori 50 milionë jetë njerëzish, e bënte sigurimin e ndërprerjes së biznesit çdo vit, duke përfshirë edhe vitin e kësaj pandemie që ndodhemi. Dhe sot, pavarësisht se është ndërprerë biznesi i saj për shkak të COVID-19, ajo ka të mbuluar nga kompania e sigurimit edhe pagat e punonjësve, edhe fitimin e munguar dhe çdo gjë që ka të bëjë me biznesin e saj.

E pra, gjithçka është e mundur, por për ne është pak e vështirë ta kuptojmë dhe besojmë, por ja që ekzistojnë edhe këto sigurime edhe këto mbulime, sepse kjo industri i ka edhe ekspertizat dhe kapacitetet financiare.

Fatkeqësisht, industria e sigurimeve në Shqipëri është shoqëruar gjatë gjithë këtyre 30 viteve të ekzistencës së saj nga një lloj “pandemie”, ku rritja për frymë e sigurimeve është vetëm 30 euro, pra me 1 euro në vit.

Në të gjithë këtë peisazh ndikon trashëgimia jonë e një men-

taliteti komunist, ku mendohet që është shteti ai që duhet të na nxjerrë nga çdo fatkeqësi dhe nuk e shohim si përgjegjësi individuale. Ose e kuptojmë këtë si një mbështetje për industrinë e sigurimeve.

Por në fakt nuk është kështu. Sigurimet dhe zgjerimi i tyre janë një mbështetje për qytetarët dhe rritje e personalitetit të tyre. Në vende ku nuk ka industri sigurimi të zhvilluar dhe ku individi është tërësisht i varur nga shteti, detyrimit mungojnë dhe liritë e individit, në themel edhe demokracia. Sepse pavarësia e individit dhe liritë e tij fillojnë nga financat dhe rriten ngadalë së bashku me to.

Ajo që bota ka mësuar ndër vite e shekuj, është se nuk mund t'u shpëtosh dot pandemive dhe katastrofave natyrore. Ndaj, është e nevojshme që shteti të implementojë politika parandaluese si përgjigje ndaj katastrofave natyrore. Qeveria duhet të marrë në konsideratë përdorimin e metodave të hartuara nga ekspertë që kanë studiuar qasjet për parandalimin dhe përbalimin e efekteve prej fatkeqësive natyrore, duke vendosur në rang kombëtar sigurimin ndaj katastrofave natyrore.

Si përfundim, duhet thyerje e konceptit se këto gjëra i rregullon qeveria, dhe duhet kaluar në ekonominë reale të tregut, ku gjithkush është përgjegjës për çfarë ka krijuar. Pra, duhen reforma të thella që njerëzit të dinë ku të drejtohen në rast fatkeqësish. Ne kemi fatin që nuk mund të eksperimentojmë, por mjafton të përshtasim legjislacionin me vendet e Komunitetit Evropian, duke ulur rolin kujdestar të Qeverisë dhe duke rritur rolin e qytetarit, i cili është pjesë e ekonomisë së tregut.

Është e rëndësishme të themi se tregu i sigurimeve në Shqipëri është i risiguruar në kompanitë më të mëdha të risigurimit në botë dhe hapësira që ne kemi për të siguruar katastrofa, pandemi apo çdo lloj ngjarje tjetër shkon jo në miliona, por në miliarda euro.



Klodiana Azazi


INOVEST

Sektori i ndërtimit është një nga veprimtaritë më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare, që ndikon drejt për drejt në zhvillimin ekonomik të vendit. Ky sektor ka një ndikim direkt në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB), ku në vitin 2019 aktivitetet e pasurive të paluajtshme kanë pasur një ndikim në rritjen e PBB-së me +0,51 pikë përqindje dhe vetë ndërtimi me +0,43 pikë përqindje. Ndikimi i këtij sektori vihet re në shumë aspekte siç janë punësimi, taksat e paguara në pushtetin vendor, likuiditeti qarkullues, zhvillimi në infrastrukturë, zhvillimi i zonave, etj.

Kriza ekonomike botërore e vitit 2008 kishte një ndikim të ndjeshëm edhe në ekonominë shqiptare, ku ndërtimi u prek ndërkohë që duket se një krizë tjetër pritet ta rigodasë, sikurse edhe sektorë të tjerë të biznesit. COVID-19 nuk rrezikon vetëm shëndetin, por edhe ekonominë. Izolimi dhe paralizimi i jetës publike, paniku dhe frika, shkurtimi i vendeve të punës do të ndikojnë në një ulje të përgjithshme të nivelit ekonomik.

COVID-19 DHE FAKTORËT E BRENDSHËM, NJË KRIZË E RE NË SFOND

Ndikimi negativ i COVID-19 pritet të sjellë



NDIKIMI I SEKTORIT TË NDËRTIMIT NË EKONOMINË SHQIPTARE

një recesion botëror, ku eks-zpertët parashikojnë një tkurrje të ekonomisë botërore këtë vit me 1.5%. Ekonomia shqiptare dhe vetë sektori i ndërtimit pritet të përballet me rënie çmimesh hipotekore, rënie çmimesh kolaterale, mungesa shitjesh, rritje të numrit të papunësisë. Pandemia po godet kërkesën, ofertën, por mbi të gjitha, po shkakton një krizë likuiditeti.

Sektori i ndërtimit, përpos situatës së përgjithshme të krijuar nga COVID-19 kërkon edhe një

analizë të dedikuar të tregut vendas dhe faktorëve specifikë, si një reagim për tejkalimin e krizës. Aktualisht, ka një tendencë në rritje të ndërtimeve të reja kryesisht përqendruar në Tiranë. Një zonë me interes investimi po kthehet gjithashtu edhe zona bregdetare e Shqipërisë.

Në kushtet kur numri i lejeve të ndërtimit është i lartë, çmimet janë gjithashtu në një nivel të lartë dhe të dy këto faktorë janë në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin e përgjithshëm të popullsisë

dhe nivelin e përgjithshëm ekonomik të vendit, nevojitet një analizë e tregut dhe e kërkesë-ofertës.

NJË PËRGJIGJE E KOORDINUAR NDAJ NJË KRIZË TË MUNDSHME

Dy elementët e përmendur më lart kërkojnë një përgjigje dhe sistem menaxhimi nga ana e kompanive ndëtuëse. Në përgjigje të këtyre faktorëve si edhe të krizës së shkaktuar nga COVID-19, kompanitë ndërtuese duhet të hartojnë

në mënyrë të shpejtë një strategji zhvilluese, duke u fokusuar në sjelljen e formave të reja të menaxhimit të pronës, të cilat mund të jenë modele të provuara në rajon dhe në Evropë si “property share”, “renting program”, “hotel apartments”. Ndërkohë, nevojiten edhe forma të reja të gjenerimit të një tregu më të madh, duke krijuar mundësi për klientë blerës nga rajoni dhe ndërkombëtarë. Në qendër të vëmendjes duhet të jenë edhe zonat e reja të investimeve, zonat periferike në Tiranë, zonat bregdetare jo vetëm në Durrës, por edhe në Jug. Ulja e çmimeve dhe sigurimi i skemave financuese për klientët janë domosdoshmëri.

Si një përgjigje ndaj COVID-19 dhe për të mos përsëritur krizën e 2008-ës, ndërtimi ka nevojë për një përgjigje të organizuar dhe për të ndryshuar mënyrën e menaxhimit. Le të dalim nga kjo krizë më të koordinuar, pasi ekonomia jonë ka nevojë për një vazhdueshmëri të sektorit të ndërtimit.

COVID 19- ECONOMIC NEWS



PASOJAT COVID-19 NË TREGUN BANKAR SHQIPTAR - RAPORTI BEI: KREDIA DO TË NDIKOHET NEGATIVISHT, POR TREGU KA NJË POZITË TË KENAQSHME

Banka Europiane e Investimeve (EIB) ka publikuar raportin më të fundit periodik për sektorin bankar në vendet e Europës qendrore dhe juglindore, ku në analizë merret edhe Shqipëria. Raporti i ri reflekton edhe situatën e krijuar nga Covid-19. "Kërkesa për hua në Shqipëri rezulton nën pritshmëritë, duke rënë gjatë 6 muajve të kaluara, dhe duke rënë në territor neutral pas 2 vitesh me trendin në rritje".



2000-2017, EKONOMIA E SHQIPËRISË VARET NGA BU- JQËSIA, RAJONI ZGJERON PRODHIMIN

Në dy dekadat e fundit, nga viti 2000 deri më 2017, struktura e ekonomisë shqiptare dominohet nga bujqësia, një tregues që lajmëron se Shqipëria, ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, do ta ketë më të vështirë të rrisë produkti-

vitin dhe të arrijë standardet e BE-së edhe për shumë dekada të tjera, thotë një studim i Forumit Ekonomik të Vjenës, në lidhje me produktivitetin në rajonin tonë.

KREDIA E BIZNESIT ME GA- RANCINË E DYTË, DENAJ: MUNDËSIA PËR TË LEHTËSUAR INTERESAT

Qeveria mund të rishikojë interesat e kredive për biznesin nëpërmjet garancisë të dytë sovraane. Në garancinë e dytë sovraane, sipas vendimit të miratuar nga qeveria është parashikuar aplikimi i interesave 5%, kredi që nuk do të përdroshin jo vetëm për pagat e punonjësve, por edhe për shlyerje të faturave të biznesit, për kapital qarkullues apo për lëndë të parë.

AKTI NORMATIV: NËSE KENI PAGUAR PUSHIME, DO TË MER- RNI KUPONË OSE DO TË MERRNI RIMBORSIM BRENDË NJË VITI

Këshilli i Ministrave ka miratuar një akt normativ, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, i cili ka për objekt përcaktimin e masave të veçanta që do të merren në sektorin e turizmit, për agjencitë e udhëtimit, operatorët turistikë dhe klientët e tyre, në ofrimin e një shërbimi udhëtimit, nga dita e shpalljes deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19.

BIZNESET RREZIKOJNË TË PAGUJNË GJOBË RRETH 2 MILION EURO PËR DËSHTIMIN PËR TË NDIHMUAR PUNONJËSIT E TYRE

Janë rreth 5 mijë punonjës, të cilët do të marrin direkt ndihmën financiare prej 40 mijë lekësh nga paketa e dytë, pasi punëdhënësit

nuk kishin aplikuar në sistem për ta. Lista u publikua nga Drejtoria e Tatimeve, e cila njoftoi dhe procedurat që duhet të ndjekin këta individë për të marrë pagën.



RREZIK I ULËT PËR PASTRIM PARASH - PENSIONET PRIVATE, NDËRMARRJET PUBLIKE, SIG- URIMI I JETËS PËRJASHTOEN NGA LISTA E RREZIQEVE

Një seri subjektsh financiarë që nisin nga kompanitë e sigurimit të jetës, skemat e pensionit, apo kompanitë publike janë përjashtuar nga rreziku i pastrimit të parave. Përmes një vendimi të miratuar më 10 qershor, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar faktorët tregues të situatave me risk të ulët të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, për të cilat mund të zbatohet vigjilenca e thjeshtuar.

PAGA MESATARE SHQIPTARE RRITET NË 428 EUR NË MUAJ NË TMI

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, paga mesatare në Shqipëri ishte 53.232 lekë, ose 428 EUR, sipas të dhënave nga INSTAT. Kjo tregon një rritje prej 3.3% kur krahasohet me të njëjtin tremujor në vitin 2019. Fatkeqësisht, ata që punojnë në industrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit kanë një pagë mesatare që është më e ulët për 36.4%. Paga mesatare në këtë sektor u ul me

10.8% në krahasim me shifrën e vitit të kaluar në vetëm 33,850 lekë (272.50 EUR).



PROJEKTI PËR COVID-19, BB: NUMRI I SHITRETERVE DO TË RRITET, 12.6 PËR 100 MIJË BANORË

Kriza e COVID-19 ka detyruar vendet që të shohin mundësitë për të rritur numrin e shtretërve në spitalet e tyre, nën frikën se vala e pandemisë mund të rrisë numrat në mënyrë të shpejtë duke vënë nën presion sistemin shëndetësor. Shqipëria duket se nuk bën përjashtim nga kjo tendencë. Detajet zbardhen në projektin që është dorëzuar pranë Bankës Botërore, për të cilin u kërkuva fillimisht një shumë 16.2 milionë dollarë, por pas detajimit të komponentëve ka rezultuar 16.6 milionë dollarë.

BIZNESET E TIRANËS MARRIN FATURA TË RRITURA (NGA IN- CENERATORI) I TAKSAVE LOKALE

Bizneseve u ka shkuar në javët e para të qershorit fatura që duhet të paguajnë për taksat lokale të këtij viti. Faturat kanë qenë të rritura për shkak të shtrenjtimit të tarifave të pastrimit pas një vendimi të Këshillit Bashkiak të Tiranës, "Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë e Tiranës", që u mor në fund të 2019-s, për të cilin shumë biznese nuk kanë qenë në dijeni.